

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI
TE KUFIZUAR " E.A. Services "SH.P.K**

Sot me date 15/08/2021/ me cilesine e ortakeve themelues ,une **Albana Kaja** e bija e **Xhimi** dhe e **Vitori** ,datelindja 24.06.1982 ,me shtetesi dhe kombesi shqiptare, lindur ne Patos dhe banues ne Patos, Fier,shpreh vullnetin per hartimin e keti Akt Themelimi te shoqerise "**E.A. Services**" *Sh.p.k*

Me neneshkrimin e ketij akti themelimi te shoqerise tregtare, une nenshkruesja dhe themeluesja e saj marre persiper te realizoje e te respektoje, te drejtat dhe detyrimet me precezimet e meposhtme:

NENI 1

Ne perputhje me kerkesat e ligjit 9901 date14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ligjit 9723 date 08.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" eshte formuar shoqeria tregtare '**E.A. Services** "SH.P.K

NENI 2

Shoqeria e ka seline e saj ne Patos Lagja "Lagjja 1 Maj, Rruga Shetitorja Republika, Godina 5, Hyrja 1, Apartamenti 2, Kati 1 Zona kadstrale 2890

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise parashikohet pa afat ,por ky afat mund te nderpritet apo te zgjatet me tej ,gjithmone ne funksion te kompetencave te ortakeve themelues te saj.

NENI 4

Si rregull aktiviteti i shoqerise mund te zhvillohet ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë ,por ai mund te ushtrohet dhe jashte ketij territori ,me hapjen e filialeve apo nepermjet veprimtarive te tjera te karakterit tregtar.

NENI 5

Themeluesi i vetem i Shoqerise "**E.A. Services** "SH.P.K me akt themelimi merr persiper qe te respektoje te gjitha detyrimet qe parashikon legjislacioni tregtar e civil shqiptar per shoqerite tregtare me pergjithesi te kufizuar , si dhe ti permbahet



kriterit te respektimit te politikës tregtare qe zhvillohet sot ne Republiken e Shqiperise.

NENI 6

Kapitali themeltar i Shoqerise " **E.A. Services** "SH.P.K ne momentin fillestar te krijimit eshte 100 000. (Njeqidmije) leke, i cili eshte regjistruar ne llogarine e shoqerise prane bankes shqiptare.

Me legalizimin e Shoqerise ne organet kompetente te shtetit Shqiptar dhe me fillimin e ushtrimit te aktivitetit te saj, kapitali Themeltar i kesaj shoqerie mund te zmadhohet .

NENI 7

Shoqeria "**E.A.Services** " SH.P.K ashtu sikurse eshte parashikuar ne Aktin Themelues te Shoqerise ,aktivitet te saj kryesor do te kete :

Zhvillim software, faqe interneti, platforma komunikimi, instalim, përshtatje. Zhvillim I software aplikative në platform të ndryshme programimi, Content Management, Case Management, Dokument Management, Portale, Interoperabilitet, e të tjera të përafërta. Shërbime mbi software aplikative të zhvilluara nga vetë Shoqëria 'E.A.Services' SH.P.K, ose software të tjera ku ka kompetenca. Implementimi I sistemeve Database, Middleware, BI, Data Warehouse dhe platformave që shërbejnë për zhvillim aplikacionesh objekt i veprimarisë. Konsulencë në fushën e programeve kompjuterike dhe informatike. Solution Desing për software aplikative. Menaxhimi i Projekteve me objekt ITC (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit). Shitja e produkteve dhe shërbimeve që ka objektin e veprimtarisë. Shitja e paisjeve ITC. Software si shërbim. Shërbime të adoptimit dhe të përshtatjes së software-ve. Shërbime të përpunimit të të dhënave. Shërbime të hostimit të bazave të të dhënave. Dizënjim, programim, zhvillim, konsulencë, shërbime dhe veprimtari në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Eksport-import dhe tregtim i sistemeve për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve, hardware, software dhe të gjitha periferikeve të tyre.

NENI 8

Ortaket e shoqerise kane vendosur qe si administrator i Shoqerise "**E.A.Services**" Sh.p.k te jete znj. Albana Kaja.

Ajo pergjigjet mbi bazen e kompetencave te saj te percaktuara ne aktin e themelimit te shoqerise. Gjithashtu ajo merr persiper se do konfirmoje emrat e ortakeve qe mund te shtohen ,pjeset e kapitalit themeltar si dhe shumen e derdhur nga secili prej tyre.



Gjithashtu ajo pergjigjet per administrimin e vlerave pasurore te Shoqerise , te cdo natyre qofshin ,te shlyeje detyrimet qe ka Shoqeria me te tretat brenda vleres se kapitalit ,te beje mbi bazen e kontributeve te dhena shperndarjen e fitimit.

Si organ ekzekutiv i Shoqerise ,te drejttat dhe detyrat e administratorit ,rregullohen me aktet themeluese te Shoqerise, Statutin e Shoqerise si dhe aktet e tjera normative te nxjerra nga Asmbleja e Ortakeve apo dhe me marrveshje te vecanta.

NENI 9

Mandati I Administratorit ,per administrimin ne kete shoqeri ,eshte per nje periudhe deri ne 5 (pese) vjet .Administratori i shoqerise emerohet Znj Albana Kaja

Administratori apo ai qe i delegohet ky pushtet ,ka te gjitha kompetencat te cilat ai deklarohet se i njeh dhe i pranon ,per te kryer te gjitha detyrimet qe i lindin ne baze te statutit te Shoqerise , sikurse parashikohet ne legjislacionin e Shtetit shqiptar dhe ne menyre te vecante ne "Tre Ligjet per Shoqerite Tregtare "

NENI 10

Kjo kontrate Themelimi hartohet ne Fier ne 5 ekzemplare origjinale ,duke patur secila nga kopjet vlere te barabarte ligjore e kuptimore.

NENI 12

Ortaku themelues **Albana Kaja** deklarohet se i njeh te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga ky Akt – themelues I Shoqerise " **'E.A.Services" Sh.p.k** dhe me vullnet te lire e firmos ate .

PER SHOQERINE " 'E.A.Services" Sh.p.k

ORTAKU

Albana Kaja

